

KOSOVA VEND I

DEMOKRACIA



DEMOKRACISË

ZHVILLIMI I DEMOKRACISË

DENIS (10), DENISA (10), ELMETIN (10), ERMAL (10), DONAT (11), RIOLT (10), ANDI (9), LYRA (10), ELTON (10), ALTIN (10)

Artikulli ynë flet për historinë e demokracisë. Ajo ka lindur në Athinë të Greqisë. Lexoni për më shumë

Demokracia fillimisht u përhap në Athinë, në vitin 507 para erës sonë (para lindjes së Krishtit).

Ajo ishte direkte, ku vendimet i merrte populli drejtëpërdrejt. Në votime, gratë nuk ishin të përfshira, por vetëm burrat. Më vonë, u shfaq demokracia përfaqësuese, ku populli përmes zgjedhjeve vendos për përfaqësuesit e tij.

Në demokraci të rëndësishme janë: përgjegjësitë, të drejtat e njeriut, respekti për të tjerët, barazia mes gjinive, racave, feve, moshave, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, ndarja e pushtetit, zgjedhjet e lira, liritë e njeriut dhe fëmijëve. Këto të fundit janë shumë me rëndësi për ne.



Demokracia direkte dhe përfaqësuese



Nxënësit duke punuar së bashku



Grupi „Shega“ për demokracinë



Të gjithë për demokracinë

ROLI IM SI QYTETAR

FATLINDA (10), GONETA (10), ERIONA (10), BLIN (10), ELMA (11), EDON (11), SHPAT (10), DARD (10), ERIN (12)

Mendimet tona për qytetarinë aktive

Të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta pa dallim gjinie, feje, ngjyre apo race. Po ashtu, ne të gjithë e kemi lirinë e shprehjes së mendimit. Ne si qytetarë aktiv duhet të japim kontributin tonë si në shtëpi, shkollë, në lagje dhe në shtetin tonë. Ne të gjithë kemi të drejta dhe përgjegjësi. Ne kemi të drejtën e shkollimit dhe të punës. Kurse, disa nga përgjegjësitë tona janë: ta ruajmë vendin tonë, ta mbajmë ambientin pastër, t'iu ndihmojmë të tjerëve, të jemi të sjellshëm dhe të punojmë për të mirën e vendit. Ne si qytetarë aktiv duhet të zbatojmë vlerat e demokracisë, si p.sh. respektin, tolerancën, ndihmën etj. Si qytetarë aktiv, ne po ashtu mund të organizojmë edhe tubime publike për të mirën e vendit tonë.



Autorët e artikullit




Ne si qytetarë aktiv



Roli im në botë



Së bashku mund të bëjmë ndryshime



Ne jemi e ardhmja e vendit

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

OLTION (10), BURHAN (10) ERLETA (9), KRON (10), MAL (10), DARIS (10), ALBULENA (10), OLTA (10), BENET (10), OLISA (10)


Kuvendi i Republikës së Kosovës, i shërben popullit duke i mbrojtur interesat e tij

Kosova është vend demokratik parlamentar. Kuvendi përbëhet prej 120 deputetëve, të cilët shprehin mendimet e tyre për një të ardhme sa më të mirë. 100 prej tyre janë shqiptarë, kurse 20 të tjerë janë prej komuniteteve jo shumicë. Ata janë komuniteti serb, romë, ashkali, turk, egjiptian, goran dhe boshnjak. Deputetët zgjedhen nga populli, me anë të votave të qytetarëve. Aty miratohen ligjet, të cilat kanë të drejtë t'i propozojnë vetë deputetët, Qeveria, Presidenti, si dhe nëse mblidhet një grup prej 10.000 qytetarëve. Këto ligje miratohen duke mbajtur mbledhje, e këto mbledhje quhen seanca plenare, të cilat transmeto-


hen nga mediat e ndryshme si televizionet, radiot, etj. Kuvendi dhe seancat plenare udhëhiqen nga kryetari i Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës kryen tri funksione kryesore:

1. Funksioni përfaqësues, që do të thotë se deputetët përfaqësojnë qytetarët që i kanë votuar ata;
2. Funksioni legjislativ, që do të thotë se deputetët kanë të drejtë të propozojnë projektligje dhe t'i miratojnë ligjet duke i votuar në seanca plenare; dhe
3. Funksioni i kontrollit, ku Kuvendi ka për detyrë të mbikëqyr Qeverinë, të shikoj nëse puna e tyre kryhet si duhet, nëse ata e respektojnë ligjin etj.



Detyrat e Kuvendit të Kosovës



Kuvendi, shtëpia jonë



Duke shkruajtur për Kuvendin e Kosovës



Demokracia na bën të lumtur

INSTITUCIONET E PUSHTETIT

DRILON (10), LEND (10), EDIS (10), DIAR (11), ERIN (10), DINA (10), ENEA (10), ENSAR (11)

IBRAHIM (10)

Qëllimi i institucioneve të pushtetit është mirëqenia e popullit


Në demokraci pushteti ndahet sepse nuk duhet të ngarkohet vetëm një institucion, prandaj i ndajnë punët. Tri pushtetet janë: Pushteti Ekzekutiv, Pushteti Legjislativ, si dhe Pushteti Gjyqësor.

Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi, në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria, ndërsa në Pushtetin Gjyqësor bëjnë pjesë gjykatat.

Detyrat e këtyre institucioneve janë: Qeveria ka për detyrë të propozoj ligje edhe t'i zbatoj ato. Kuvendi miraton ose nuk miraton ligjet. Ndërsa, gjykata ka për detyrë ta gjykojë personin që e thyen ligjin. Ne dëshirojmë që të mësojmë dhe në të ardhmen të jemi persona sa më demokratik.



Autorët e artikullit



Institucionet janë të pavarura



Kujdes me ligjin, respektojeni atë



Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor



Diskutimi ynë rreth ndarjes së pushtetit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë